



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIËSË - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY	
Njësi Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2241
Data. Datum. Date:	18.05.20

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

Nr. 01/09

Prishtinë, 18.05.2020

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, mbështetur në nenin 119.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 37.2.7, 49.1.12 dhe 59 të Ligjit 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit dhe nenet 13 dhe 17.8.1 të Ligjit 04/L-176 për turizmin, në përputhje me nenin 11 të Ligjit 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura dhe nenin 8.1.4 dhe pikën 3 të shtojcës 7 të Rregullores së Qeverisë 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe duke pasur parasysh Vendimin e Qeverisë 01/09 të 13 marsit 2020, nxjerr këtë:

URDHËRESË
për shtyrjen e shërbimeve turistike

1. **Urdhërohen** subjektet turistike që, përmes kuponëve (*vouchers*) ose dokumenteve të barasvlershme, t'u mundësojnë:
 - 1.1. shtyrjen deri më 31 dhjetor 2021 të shërbimeve turistike të parapaguara ose të rezervuara turistëve të cilët nuk kanë mundur të udhëtojnë për shkak të pandemisë COVID-19;
 - 1.2. zëvendësimin e paketave me paketa të cilësisë së njëjtë ose më të lartë konsumatorëve të cilëve u janë anuluar paketat turistike për shkak të pandemisë COVID-19; dhe nëse paketat zëvendësohen me paketa të cilësisë më të ulët, konsumatorëve t'ua kthejnë dallimin në çmim.
2. Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Rozeta HAJDARI



Ministre në detyrë

U dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm
- Departamentit të Turizmit
- Departamentit Ligjor
- arkivit